



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 90, Datë 22.05.2020

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SHA, PËR BARRËSIM TË ASETEVE TË  
LUAJTSHME (MAKINERI DHE PAJISJE) NË FAVOR TË BANKËS “OTP ALBANIA” SHA,  
PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË PËR FONDET E PËRDORURA, ME  
QËLLIM FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË HEC-IT “DARDHA 1”.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, pika 1 dhe nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.05.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/7 Prot, datë 17.02.2020 dhe relacionet shtesë të depozituara në datë 23.03.2020, dhe datë 20.05.2020, të përgatitura nga “Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes” si dhe “Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve”, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “WENERG” sha, për lënien barrë të asetëve në favor të bankës “OTP Albania” sha,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “WENERG” sha, rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 18.09.2009 është licencuar nga ERE, për ushtrimin e aktiviteteve të prodhimit dhe tregimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “WENERG” sha, i është drejtuar ERE-s me shkresën e saj nr. HD1-5/20, prot. datë 31.01.2020, duke kërkuar, miratim për lejimin e barrësimit të *asetëve të luajtshme (makineri dhe pajisje)* në favor të bankës “OTP Albania”sha, për ristrukturimin e kredisë, fonde të cilat shoqëria deklaron se do ti përdorë për ndërtimin e Hidrocentralit "Dardha 1".  
Në këtë kërkesë, shoqëria ka bashkëlidhur dhe dokumentacionin për trajtimin e kësaj kërkesë.
- Kërkesa e shoqërisë “ WENERG”sha, përcillet në ERE në mbështetje të parashikimeve të Ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar si dhe “Rregullore e procedurave të

transferimit të aseteve nga të licencuarit” miratuar me vendimin nr.119, datë 21.07.2016, të bordit të ERE-s,

- Qëllimi i kësaj rregullore në zbatim të përcaktimeve të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 44 të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, është përcaktimi i procedurës dhe dokumentave të nevojshme për miratimin e kërkesave të të licencuarve për shitje, dhënie me qera, transferim, hipotekim, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të **pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit**, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë për miratimin nga ERE të barrësimit të aktiveve të luajtshme (makineri + pajisje), rezulton se:
  - Aktivitet e luajtshme i përkasin aktiveve afatgjata jo materiale ose jo fikse.
  - makineritë dhe pajisjet i përkasin grupit të aktiveve afatgjata materiale ose fikse të cilat janë objekt trajtimi i *"Rregullores se procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit"*.
- Lista e aseteve e cila është përcjellë në ERE bashkëlidhur kontratës në fjalë, nuk është e lexueshme dhe e aksesueshme, në mënyrë që të evidentohen asetet fikse të cilat i përkasin veprimtarisë së licencuar.

Subjekti konçensionar “Wenerg” sha, me kontratë konçesioni të formës BOT me nr. 6144 Rep dhe nr. 2021 Kol, datë 18.08.2009, bazuar në deklaratimet e bëra në Pasqyrat Financiare lidhur me pasqyrimin e aseteve, ka njohur asetet sipas modelit të aktivitetit jo-material në zbatim të përcaktimeve të SNK 13 dhe SKK5, por mbështetur në KIRFN 12, subjekti konçensionar duhet të marrë paraprakisht autorizim prej konçensiondhënësit, (ish METE, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për lënien peng të aseteve, meqënëse kontrolli i konçensiondhënësit mbi çdo interes të mbetur të konsiderueshëm do të kufizonte aftësinë praktike të operatorit (subjekti konçensionar) për të shitur ose dhënë peng infrastrukturën.

- Shoqërisë “WENERG” sha, me e-mail-in e datës 31.03.2020, i’u dergua një shkresë nëpërmjet së cilës i’u kerkua saktësimi i objektit të kërkesës së saj si dhe depozitimi në ERE në formë analitike, vetëm i listës se pajisjeve apo aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar për të cilat kërkohet barrësim, në përputhje me bilancet financiare të miratuara të shoqërisë.
- Meqënëse bazuar në përcaktimet e gërmës “b” të nenit 4 të *"Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit"*, përcaktohet se: *Kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 150.000.000 lekë. (njëqind e pesëdhjetë milion)*, dërgimi i informacioneve dhe shpjegimeve nga ana e shoqërisë do të mundësonte gjithashtu vlerësimin nëse kërkesa është në përputhje me parashikimet e rregullores së transferimit të aseteve.
- Rezulton se shoqëria “WENERG” sha, nuk ka depozituar në ERE shpjegime apo informacion për sa kërkuar në shkresën e lartpërmendur, me qëllim saktësimin e objektit të kërkesës së saj.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “WENERG” sha, për barrësim të aseteve në favor të bankes “OTP Albania” sha, për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC-it “Dardha 1”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**